

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>31.05.2022</u>	REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY Pranuor <u>31/05</u> 20 <u>22</u>								
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini:	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 25%;">Nj. Org</td> <td style="width: 25%;">Numër</td> <td style="width: 25%;">Shënim</td> <td style="width: 25%;">Vlera</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">01-</td> <td style="text-align: center;">06/05-</td> <td style="text-align: center;">22191</td> <td></td> </tr> </table>	Nj. Org	Numër	Shënim	Vlera	01-	06/05-	22191	
Nj. Org	Numër	Shënim	Vlera						
01-	06/05-	22191							
<u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak ☒ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐									
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>13</u>									
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?									
Po / Da ☐ Jo / Ne ☐ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐									
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?									
Po / Da ☐ Jo / Ne ☐ Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju									
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?									
Po / Da ☐ Jo / Ne ☒									
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu: Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:									
1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/03/Procesverbali-i-KKSBB-se-dhe-ftesa-e-dates-15.03.2022.pdf 2. Situata me zjarret fushore dhe malore në komunën e Drenasit 3. Të ndryshme									
Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:									

Konkluzionet / Zaključci:

Me datë 13 maj është mbajtur mbledhja e tretë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Kjo mbledhje u kryesua nga përfaqësuesi i stacionit policor në Drenas, Florim Geci, dhe të pranishëm ishin Drejtoresha për Shërbime Publike, Lumnije Krapë, Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, njëherësh koordinatore e KKS-së, Laureta Thaqi dhe anëtarët e këshillit sipas listës së pjesëmarrjes.

Mbledhja e ditës u miratua me këtë rend dite:

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKS-së: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/03/Procesverbali-i-KKS-se-dhe-ftesa-e-dates-15.03.2022.pdf>

Kjo pike u miratua në mënyrë unanime dhe nuk ka pasur diskutim.

2. Situata me zjarret fushore dhe malore në komunën e Drenasit.

Ndërsa, të pika e dytë, Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapë njoftoi se situata me zjarret fushore dhe malore në dy muajt e fundit ka qenë shqetësuese.

Ajo ka theksuar se duhet një mobilizim më i madh që gjatë muajt të verës kjo dukuri shqetësuese të parandalohet.

“Intervenimet e zjarrfikësve janë kryesisht në zjarre fushore e malore. Bazuar në raportin e zjarrfikësve janë shkaktuar 80 zjarre fushore malore të përmasave të mesme dhe të mëdha. Kemi bërë apele që të kenë kujdes të shtuar qytetarët pasi shumica e zjarrëve shkaktohen nga faktori njeri”, ka thënë mes të tjerash drejtoresha Krapë.

Edhe z.Geci nga policia u shpreh se për këtë dukuri duhet një bashpunim zingjiror nga të gjithë akterët që mund të ndikojnë në parandalimin e djegies së maleve dhe fushave kur bëhet nga faktori njeri.

“Lidhur me zjarret ne bazuar në të dhënat kemi tri raste të hapura, procedura që janë inicu dhe janë përgaditë për me u dërgu në gjykatë. Janë 8 shënime zyrtare dhe 16 raporte policore”, ka deklaruar ai.

Ndërsa, edhe përfaqësuesit e KKS-së adresuan pyetje lidhur me situatën me zjarre në Drenas, duke kërkuar që të bëhet një fushatë më e madhe vetëdijësuese për qytetarët që të kenë kujdes për natyrën.

Donika Zogu, nga KVRL theksoi së gjatë vitit 2020 kanë bërë një video senzibilizuese duke përfshirë qytetarët, zyrtarët dhe zjarrfikësit, projekt ky që është shpërndarë në rrjetet sociale dhe në ueb faqen e komunës.

Arben Nika, përfaqësues i EVSB-së, parashtroi disa pyetje dhe kërkesa. Ai kërkoi që të bëhet më shumë hapje rrugore dhe një fushatë që do të përfshinte të gjithë qytetarët.

Drejtoresha Krapë informoi se kanë impiantet e ujit, duke shtuar se zjarrfikësit janë vetëm për fikjen e zjarrit ndërsa për parandalim dhe të tjerat secila drejtori ka kompetencat e saj. Ndërsa, shtoi se në buxhetin e DSHPE-së gjithmonë përfshihen kërkesat e zjarrfikësve që adresohen nga shefi i zjarrfikësve.

Afrim Gjeli, Shefi i Njesisë së Zjarrfikësve informoi të pranishmit për rastet e zjarrvënies dhe disa terrene. Ai tregoi se punën e tyre, përkatësisht intervenimet i bazojnë në Planin e Reagimit Kombëtar dhe Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave, du dokumente bazë. Poashtu, tregoi se shpesh në disa raste edhe KEDS vonon në intervenimin, përkatësisht ndaljen e energjisë elektrike.

Kërkesat që kanë dalë nga kjo mbledhje e KKSB-së:

Plan i detajizuar i veprimit për parandalim të zjarreve (bashkë me ekspertë)
Fushata vetëdijuese duke u nisur nga qeverisja lokale dhe në bashkëpunim me shoqatat, OJQ-të, qytetarët etj.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laura Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime / potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:
Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Gadrovci
Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 31.05.2022

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.